



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 361/3 Prot.



Fier, më 06/03/2026

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

• Drejtoria së Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të shtatë akteve administrativ – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :

- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.21, me nr.360/2 Prot., datë 16/02/2026, i materializuar për subjektin “BIMBA SHOES” sh.p.k me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagjja “8 Shkurti”, Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288, zona kadastrale 3984).
- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.22, me nr.361/1 Prot., datë 16/02/2026, i materializuar për subjektin “BIMBA SHOES” sh.p.k me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagjja “8 Shkurti”, Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288, zona kadastrale 3984).
- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.23, me nr.363/1 Prot., datë 16/02/2026, i materializuar për subjektin “BIMBA SHOES” sh.p.k me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagjja “8 Shkurti”, Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288, zona kadastrale 3984).
- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.24, me nr.362/1 Prot., datë 16/02/2026, i materializuar për subjektin “BIMBA SHOES” sh.p.k me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagjja “8 Shkurti”, Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288, zona kadastrale 3984).

• Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.26, me nr.576/2 Prot., datë 16/02/2026, i materializuar për subjektin “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1).

• Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.27, me nr.576/3 Prot., datë 16/02/2026, i materializuar për subjektin “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1).

• Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.28, me nr.577/2 Prot., datë 16/02/2026, i materializuar për subjektin “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjja “Kryengritja e Fierit”, (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531).

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike dhe ju lutemi, *ktheni përgjigje zyrtare*.

Bashkëngjitur, gjeni kopje origjinale të shtatë akteve të lartcituara - gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Eridjol XHAFI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 360/2 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r. 2 1

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022714, nr.360 Prot., datë 28.01.2026, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagja "8 Shkurti" Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288 zona kadastrale 3984), me adresë elektronike gladiolacobo@iclaud.com, si dhe praktikën doganore,

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 8624/1, datë 25.02.2022.

Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.4541 Prot., datë 03/12/2025 me lëndë “*Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” dhe më tej, me shkresën nr.4541/1 Prot., datë 16/12/2025 me lëndë “Program Pune”, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr.8624/1 datë 25.02.2022; si dhe me shkresën nr.4541/2 Prot., datë 29/12/2025 me lëndë “Informacion” .*

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 “Dokumenti i mbylljes së autorizimit”, brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës dhe për këtë konstatim, kanë mbajtur Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022714, nr.360 Prot., datë 28.01.2026, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr.360/1 Prot., datë 03/02/2026, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”

Midis të tjerave, në Udhëzimin nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, është parashikuar si detyrim për operatorin ekonomik si vijon “...*Të kryejë një bilanc tre mujor në formën e akt rakordimit në bashkëpunim me doganierin që ndjek regjimin”* .

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”. Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N ka kryer shkelje administrative të kryer në neglizhencë, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i cili parashikon si vijon : Pa çënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 252, 257/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.361/I Prot.

Fier, më 16/02/2026

VENDIM Nr.22

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022716, nr.361 Prot., datë 28.01.2026, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagja "8 Shkurti" Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288 zona kadastrale 3984), me adresë elektronike gladiolacobo@iclaud.com, si dhe praktikën doganore,

KONSTATOVA SE:

Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N dhe seli në Fier, është rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 11/01/2022 dhe ka si objekt të aktivitetit të tij midis të tjerave si vjon :
“Prodhim për të tretë të këpucëve, çizmeve, sandaleve, shapka të mbaruara ose pjesë të tyre, çanta, rripa dhe çdo prodhim tjetër lëkure. Montim e tregtim i materialeve për prodhimin e këpucëve ose të çdo prodhimi tjetër prej lëkure. Punime druri, metalike, plastike për dyer etj. Tregtim të lëndëve të para të çdo lloji, pjesëve të këmbimit, agregateve e makinerive të ndryshme industriale, ndërtimi etj., me shumicë e pakicë, import-eksport i tyre, si dhe transporti brenda dhe jashtë vendit për shoqërinë dhe persona të tretë. Prodhim e tregti materialesh të ndryshme për ambalazh. Prodhim e tregti detergjentësh, bojërash, llakësh etj. Tregtim i karburanteve dhe çdo lloj nënprodukti të tyre me pakicë dhe transporti i tyre. Eksport-import dhe tregtim me shumicë e pakicë i mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, elektrike, elektro-shtëpiake, materiale ndërtimi. Shërbime dhe riparime, servise, lavazhe automjetesh, hapjen e bar-restoranteve, hoteleve, si dhe fushën e transportit të mallrave e pasagjerëve brenda dhe jashtë shtetit. Krijimin e agjencive të transportit, speditonit, të konsulencës, komisionere e të ndërmjetësive dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar me ligj. Veprimtari private në fushën e ndërtimit, të projektimit dhe zbatimit, ndërtime civile e ekonomike shumëkatëshe, ndërtime rrugore, vepra arti, ujësjellësa, kanalizime, kanale e impiante vaditëse, vepra të veçanta e punime speciale, punime restaurimi, punime karpentierie, shërbime publike, punime publike, punime armature, murature, suvatime. Nivelim shtresash, shtrime pllakash, hidroizolimi, punime hidraulike, elektrike, veshje fasadash, ndërtime civile, montime sistemesh ngrohje-ftohje etj”.

Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 8624/1, datë 25.02.2022.

Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.4541 Prot., datë 03/12/2025 me lëndë “Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” dhe më tej, me shkresën nr.4541/1 Prot., datë 16/12/2025 me lëndë “Program Pune”, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr.8624/1 datë 25.02.2022; si dhe me shkresën nr.4541/2 Prot., datë 29/12/2025 me lëndë “Informacion”, ku midis të tjerave kanë parashtruar si vijon “...Sa i takon Taksës Doganore TDP malli i importuar ka ardhur pa certifikatë origjine EUR1 duke gjeneruar taksë doganore preferenciale në vlerën 100,597 lekë. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë observacion lidhur me këtë gjetje të grupit të punës.

Këto shkelje klasifikohen sipas neneve 250/1/a dhe 252/c “Mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim” dhe sanksionohen sipas nenit 257/1/a të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është respektuar plotësisht detyrimi për paraqitjen e dokumentacionit shoqërues që provon origjinën preferenciale të mallrave, konkretisht certifikatën e origjinës EUR.1, si kusht thelbësor për përfitimin e trajtimit tarifor preferencial.

Në kuptim të legjislacionit doganor në fuqi, regjimi i përpunimit aktiv përbën një regjim ekonomik që lejon importimin e mallrave pa pagimin e detyrimeve doganore, me kusht që këto mallra të përdoren për përpunim dhe më pas të rieksporohen, ose të marrin një destinacion tjetër doganor të lejuar. Ky rregjim doganor shoqërohet me detyrime të qarta për subjektin përfitues, të cilat burojnë drejtpërdrejt nga autorizimi i dhënë dhe nga dispozitat e Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Referuar nenit 250/1/a dhe nenit 252/c të Kodit Doganor, mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi (autorizimi), i detyrimeve që rrjedhin prej tij, përbën kundërvajtje administrative doganore. Në rastin konkret, mungesa e certifikatës së origjinës EUR.1 në momentin e importimit ka sjellë aplikimin e një norme preferenciale pa u plotësuar kushtet ligjore për përfitimin e saj, duke gjeneruar diferencë në detyrimin doganor në shumën 114,318 lekë.

Në analizë të elementëve objektivë të kundërvajtjes, konstatohet se :Ekziston një detyrim ligjor dhe kontraktual (në kuadër të autorizimit) për paraqitjen e dokumentacionit të plotë dhe të saktë; Ky detyrim nuk është përmbushur në mënyrë të plotë; Mosveprimi ka sjellë pasojë financiare në formën e aplikimit të padrejtë të trajtimit preferencial.

Sa i takon elementit subjektiv, fakti që subjekti nuk ka paraqitur observacione apo kundërshtime lidhur me gjetjen e grupit të punës përforcon konstatimin se kemi të bëjmë me një mosrespektim të detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi, pavarësisht nëse kjo ka ardhur për shkak të pakujdesisë apo neglizhencës.

Për këtë konstatim, grupi i punës ka mbajtur Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022716, nr.361 Prot., datë 28.01.2026, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes si vijon : *“Subjekti Bimba Shoes i pajisur me autorizim RPA nr.8624/1 datë 25.02.2022 nuk ka paguar taksën TDP të gjeneruar në import në vlerën 114,318 lekë. Kjo shkelje klasifikohet në nenin 252/c dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i RSH”.* Proces verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr.360/1 Prot., datë 03/02/2026, me lëndë *“Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”*.

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar), përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”*. Subjekti *“Bimba Shoes”* sh.p.k, me NUIS M22511402N ka kryer shkelje administrative të kryer në neglizhencë, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit nr.102/2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* i cili parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : 1. *Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;*

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.9590, dt. 27.07.2006 *“Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtarë”*, Ligjin nr.102/2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 *“Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”*, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, *“Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”*,

V E N D O S A :

- Subjekti *“Bimba Shoes”* sh.p.k, me NUIS M22511402N, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **114,318** (Njëqind e katërmbydhjetëmijë e treqind e tetëmbëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti *“Bimba Shoes”* sh.p.k, me NUIS M22511402N, të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **228,636** (Dyqind e njëzet e tetëmijë e gjashtëqind e tridhjet e gjashtë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.

- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penaltetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.363/1 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r.23

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022718, nr.363 Prot., datë 28.01.2026, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagja "8 Shkurti" Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288 zona kadastrale 3984), me adresë elektronike gladiolacobo@iclaud.com, si dhe praktikën doganore,

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 19157/1, datë 13.03.2023.

Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.4541 Prot., datë 03/12/2025 me lëndë “Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” dhe më tej, me shkresën nr.4541/1 Prot., datë 16/12/2025 me lëndë “Program Pune”, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr.19157/1 datë 13.03.2023; si dhe me shkresën nr.4541/2 Prot., datë 29/12/2025 me lëndë “Informacion” .

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk është dorëzuar në degën doganore mbikqyrëse Aneksi nr.8 “Dokumenti i mbylljes së autorizimit”, brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230 të Kodit Doganor, edhe pse subjekti është njoftuar nga Dega e Doganës dhe për këtë konstatim, kanë mbajtur Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022718, nr.363 Prot., datë 28.01.2026, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr.360/1 Prot., datë 03/02/2026, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”.

Midis të tjerave, në Udhëzimin nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, është parashikuar si detyrim për operatorin ekonomik si vijon “...Të kryejë një bilanc tre mujor në formën e akt rakordimit në bashkëpunim me doganierin që ndjek regjimin”.

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”*.

Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N ka kryer shkelje administrative të kryer në neglizhencë, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i cili parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

Në përfundim, u arrit në konkluzionin se nga ana e subjektit të mësipërm, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.


Për sa më lart, mbështetur në nenet 230, 250/1/a, 252, 257/1/b, 262 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.362/1 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r. 2 4

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022717, nr.362 Prot., datë 28.01.2026, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagja "8 Shkurti" Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288 zona kadastrale 3984), me adresë elektronike gladiolacobo@iclaud.com,

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N dhe seli në Fier, është rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 11/01/2022 dhe ka si objekt të aktivitetit të tij midis të tjerave si vjon : *“Prodhim për të tretë të këpucëve, çizmeve, sandaleve, shapka të mbaruara ose pjesë të tyre, çanta, rripa dhe çdo prodhim tjetër lëkure. Montim e tregtim i materialeve për prodhimin e këpucëve ose të çdo prodhimi tjetër prej lëkure. Punime druri, metalike, plastike për dyer etj. Tregtim të lëndëve të para të çdo lloji, pjesëve të këmbimit, agregateve e makinerive të ndryshme industriale, ndërtimi etj., me shumicë e pakicë, import-eksport i tyre, si dhe transporti brenda dhe jashtë vendit për shoqërinë dhe persona të tretë. Prodhim e tregti materialesh të ndryshme për ambalazh. Prodhim e tregti detergjentësh, bojërash, llakësh etj. Tregtim i karburanteve dhe çdo lloj nënprodukti të tyre me pakicë dhe transporti i tyre. Eksport-import dhe tregtim me shumicë e pakicë i mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, elektrike, elektro-shtëpiake, materiale ndërtimi. Shërbime dhe riparime, servise, lavazhe automjetesh, hapjen e bar-restoranteve, hoteleve, si dhe fushën e transportit të mallrave e pasagjerëve brenda dhe jashtë shtetit. Krijimin e agjencive të transportit, speditonit, të konsulencës, komisionere e të ndërmjetësive dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar me ligj. Veprimtari private në fushën e ndërtimit, të projektimit dhe zbatimit, ndërtime civile e ekonomike shumëkatëshe, ndërtime rrugore, vepra arti, ujësjellësa, kanalizime, kanale e impiante vaditëse, vepra të veçanta e punime speciale, punime restaurimi, punime karpentierie, shërbime publike, punime publike, punime armature, murature, suvatime. Nivelim shtresash, shtrime pllakash, hidroizolimi, punime hidraulike, elektrike, veshje fasadash, ndërtime civile, montime sistemesh ngrohje-ftohje etj”.*

Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 19157/1, datë 13.03.2023.

Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.4541 Prot., datë 03/12/2025 me lëndë “Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” dhe më tej, me shkresën nr.4541/1 Prot., datë 16/12/2025 me lëndë “Program Pune”, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr.8624/1 datë 25.02.2022; si dhe me shkresën nr.4541/2 Prot., datë 29/12/2025 me lëndë

“Informacion”, ku midis të tjerave kanë parashtruar si vijon “...Grupi i punës u paraqit në ambientet ku operonte subjekti. Ky kontroll nuk u bë i mundur, pasi magazina në të cilën operonte ky subjekt ishte e mbyllur madje ishte edhe njoftimi që kjo pronë jepej me qera e provuar kjo me fotot bashkëlidhur. .. Sa i takon autorizimit nr. 19157/1 datë 13.03.2023 situata nga sistemi Oracle është e pasqyruar sipas tabelës më poshtë :

PROCEDURA	VLERA (EURO)	PESHA (KG)
5100 (import)	129,381	14,583
3151 (eksport)	129,381	13,240
Diferenca (Importe-Eksporte-mbetje)	-	1343

Nga verifikimi në sistemin Oracle rezulton se operatori ka gjendje malli lëndë e parë pa i dhënë destinacion në sasinë 1343 kg.

Të gjendur në këto kushte Dega e Doganës Fier bazuar në Ligjin 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” sipas nenit 74 “Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërbushjes”, nenit 253/b “Mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28” dhe nenit 258/1/a ka llogaritur detyrimin në shumën :

Përlllogaritja e detyrimeve :

$129,381 \text{ euro} / 14,583 \text{ kg} = 8.87 \text{ euro/kg lende e pare}$

$Sasia 1343 \text{ kg} * 8.87 \text{ Euro/kg} * 96.7 \text{ Kursi} = 1,152,195 \text{ leke}$

$Detyrimi = 1,152,195 \text{ lekë} * 20\% = 230,439 \text{ leke}$

$Penalitet = 230,439 * 3 \text{ fishi} = 691,317 \text{ leke}$

$Totali Detyrim + Penalitet = 921,756 \text{ leke}”$

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk i është dhënë destinacion doganor mallit .

Në kuptim të legjislacionit doganor në fuqi, regjimi i përpunimit aktiv përbën një regjim ekonomik që lejon importimin e mallrave pa pagimin e detyrimeve doganore, me kusht që këto mallra të përdoren për përpunim dhe më pas të rieksporthen, ose të marrin një destinacion tjetër doganor të lejuar. Ky rregjim doganor shoqërohet me detyrime të qarta për subjektin përfitues, të cilat burojnë drejtpërdrejt nga autorizimi i dhënë dhe nga dispozitat e Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Për këtë konstatim, grupi i punës ka mbajtur Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022717, nr.362 Prot., datë 28.01.2026, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes si vijon : “Operatori ekonomik i pajisur me autorizim RPA nr.19157/1 datë 13.03.2023 ka gjendje mall lëndë të parë pa dhënë destinacion në sasinë 1343 kg.

Kjo shkelje klasifikohet në nenin 253/b dhe sanksionohet sipas nenit 258/1/a të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i RSH”. Proces verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr.360/1 Prot., datë 03/02/2026, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”.

Nga analiza e fakteve të konstatuara nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier rezulton se subjekti i pajisur me autorizim për Regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) nr. 19157/1 datë 13.03.2023 ka importuar mallra (lëndë të parë) nën procedurën 5100 në sasinë 14,583 kg dhe ka eksportuar produkt përfundimtar në sasinë 13,240 kg. Nga verifikimi në sistemin Oracle rezulton diferencë prej 1,343 kg lëndë e parë, për të cilën nuk i është dhënë destinacion doganor. Kontrolli fizik nuk është bërë i mundur, pasi ambienti ku operonte subjekti rezultoi i mbyllur dhe i nxjerrë për qira, pra, nuk është provuar ekzistenca fizike e mallrave dhe as vendndodhja reale e tyre. Në kuptim të nenit 74 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, borxhi doganor lind ndër të tjera kur një mall që i nënshtrohet një regjimi doganor nuk përmbush kushtet e këtij regjimi. Megjithatë, në rastin konkret, situata tejkalon kuadrin e një mosrespektimi formal të detyrimeve të autorizimit (neni 253/b), pasi

- a) Malli i importuar me pezullim detyrimesh doganore nuk rezulton i riekportuar;

- b) Malli nuk rezulton të jetë vendosur në një regjim tjetër doganor të lejuar;

- c) Malli nuk rezulton të jetë i pranishëm fizikisht në ambientet e subjektit;

- d) Subjekti ka pamundësuar kontrollin fizik të autoriteteve doganore, duke mos garantuar aksesin në ambientet ku duhej të ndodheshin mallrat nën regjimin e përpunimit aktiv. Ndërkohë, subjekti kishte detyrimin ligjor që, në rast të ndryshimit të adresës së ushtrimit të veprimtarisë apo të vendndodhjes së magazinimit të mallrave, të njoftonte paraprakisht autoritetin doganor dhe të siguronte miratimin përkatës, me qëllim garantimin e vijimësisë së mbikëqyrjes doganore.

Këta elementë përmbushin tiparet objektive të heqjes së mallrave nga mbikëqyrja doganore, çka sipas Kodit Doganor përbën kontrabandë dhe jo thjesht kundërvajtje administrative. Heqja e mallrave nga mbikëqyrja doganore konsiston në çdo veprim apo mosveprim që ka si pasojë pamundësimin e autoriteteve doganore për të ushtruar kontroll mbi mallrat që janë nën një regjim pezullues. Në rastin konkret, fakti që mallrat nuk gjenden fizikisht; nuk ekziston dokumentacion për destinacionin e tyre; subjekti nuk ka bashkëpunuar duke garantuar akses për kontroll; tregon se mallrat janë nxjerrë jashtë kontrollit doganor dhe mund të kenë hyrë në qarkullim të lirë pa shlyer detyrimet përkatëse. Kjo sjellje përbën shmangie nga regjimi pezullues dhe heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore. Të paktën në formën e dashjes eventuale, pasi subjekti ka qenë i vetëdijshëm për detyrimet që rridhnin nga autorizimi i RPA dhe për pasojat e mosdhënies së destinacionit doganor. Në këto kushte, kualifikimi juridik i kryer nga ana e grupit të punës sipas nenit 253/b (kundërvajtje administrative) rezulton i papërshtatshëm, pasi kjo dispozitë zbatohet kur kemi thjesht mosrespektim procedural të kushteve të autorizimit, ndërsa në rastin konkret kemi mungesë fizike të mallrave dhe shmangie nga kontrolli doganor. Për rrjedhojë,

veprimet e subjektit përbëjnë shkeljen doganore “kontrabandë”, në kuptim të dispozitave të Kodit Doganor që sanksionojnë heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe futjen e tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse. Bazuar në analizën e mësipërme, rezulton se shkelja e konstatuar nuk përbën thjesht “mosrespektim të detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi”, por përbën heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe ndoshta, futje të tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse, duke u kualifikuar si kontrabandë. Në këto kushte, Proces Verbalit nr. 0022717, datë 28.01.2026, duhet t’i bëhet rikualifikimi juridik i shkeljes nga neni 253/b në dispozitat që parashikojnë kontrabandën, si dhe çështja duhet të ndiqet sipas procedurave përkatëse për këtë kategori shkeljeje. Në vijim të këtij arsyetimi, rezulton e nevojshme të analizohet edhe dispozita e posaçme që parashikon se përbën shkelje hedhja në konsum e mallrave të importuara me pezullim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet doganore, kur autoritetet doganore vërtetojnë se destinacioni përfundimtar apo përdorimi i tyre është i ndryshëm nga ai për të cilin është përfituar lehtësia doganore. Në rastin konkret, mallrat (lëndë e parë) janë importuar nën regjimin e përpunimit aktiv, i cili përbën një formë pezullimi nga detyrimet doganore, me kusht që ato të përpunohen dhe më pas të rieksporthen ose të marrin një destinacion tjetër të lejuar. Diferenca prej 1,343 kg nuk rezulton e rieksportuar, nuk rezulton e vendosur në ndonjë regjim tjetër doganor dhe nuk provohet ekzistenca fizike e saj në magazinat e subjektit.

Në këto rrethana, kur mallrat e importuara me pezullim detyrimesh nuk gjenden nën mbikëqyrje doganore dhe nuk provohet përdorimi i tyre sipas destinacionit të miratuar, krijohet prezumimi i arsyeshëm se ato janë hedhur në konsum ose përdorur për një qëllim tjetër nga ai që justifikonte përfitimin nga pezullimi i detyrimeve. Kjo situatë përputhet plotësisht me parashikimin e nenit 266/5 të Kodit Doganor, sipas së cilës humbet e drejta e përjashtimit dhe lind detyrimi i plotë doganor. Megjithatë, në ndryshim nga një rast i thjeshtë mospërmbushjeje formale të kushteve të autorizimit, këtu kemi elementë shtesë rëndues : mungesë fizike të mallrave; pamundësim të kontrollit doganor; mosdhënie të destinacionit doganor brenda afateve; mosnjohim të ndryshimit të vendndodhjes së aktivitetit.

Këta elementë tregojnë jo vetëm lindjen e borxhit doganor sipas nenit 74, por edhe realizimin e veprimeve që çojnë në heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe hedhjen e tyre të mundshme në konsum në kundërshtim me kushtet e regjimit pezullues. Pra, ndërsa dispozita mbi “hedhjen në konsum” justifikon lindjen e detyrimit doganor dhe humbjen e përfitimit, rrethanat konkrete të çështjes – në veçanti mungesa e mallrave dhe pamundësimi i kontrollit – e tejkalojnë këtë nivel dhe e çojnë sjelljen në fushën e kontrabandës, si formë e rëndë e shmangies nga regjimi doganor. Për rrjedhojë, në analizë të plotë të fakteve dhe të dispozitave ligjore të aplikueshme, rezulton se mallrat janë importuar me pezullim detyrimesh për një destinacion të caktuar; ky destinacion nuk është provuar; mallrat nuk janë nën kontroll doganor; ekziston dyshimi i arsyeshëm i hedhjes së tyre në konsum pa përmbushur detyrimet përkatëse.

Në këto kushte, kualifikimi juridik i saktë i sjelljes së subjektit nuk është ai i një kundërvajtjeje administrative sipas nenit 253/b, por ai i shkeljes doganore “kontrabandë”, me të gjitha pasojat ligjore që rrjedhin prej saj, përfshirë rilogaritjen e detyrimeve, aplikimin e masave ndëshkimore përkatëse dhe ndjekjen e procedurave sipas natyrës së kësaj shkeljeje. Për rrjedhojë, kualifikimi i bërë fillimisht sipas nenit 253/b si kundërvajtje administrative rezulton i gabuar dhe i papërshtatshëm në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 230,439 (Dyqind e tridhjetëmijë e katërqind e tridhjet e nëntë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “Bimba Shoes” sh.p.k, me NUIS M22511402N, të penalizohet në masën e trefshit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 691,317 (Gjashtëqind e nëntëdhjet e njëmijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 268/2 të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Tërhiqet vëmendja e personelit doganor që, në raste të ngjashme ku konstatohet mungesë fizike e mallrave të vendosura në regjim pezullues, pamundësim i kontrollit doganor, mosdhënie e destinacionit doganor dhe elementë që tregojnë heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore, çështjet të mos trajtohen si kundërvajtje administrative formale, por të analizohen dhe kualifikohen në përputhje me dispozitat që parashikojnë shkeljen doganore “kontrabandë”, duke zbatuar me rigorozitet legjislacionin doganor në fuqi.
- Në përputhje me nenin 272 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, subjekti ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen administrative të shkeljes së kualifikuar si kontrabandë, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga ky nen.
- Nëse subjekti nuk kërkon zgjidhje administrativ, kundër këtij vendimi, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar parapakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
- Për vijimin e procedurave të mëtejshme, një kopje e këtij vendimi, së bashku me gjithë dokumentacionin e lartpërmendur, t’i përcillet Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë, për

veprime të mëtejshme në përputhje me kompetencat ligjore. Për zbatimin e kësaj dispozite ngarkohet Zyra Juridike pranë Degës së Doganës Vlorë.

◦ Ngarkohet Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier që të njoftojë organin tatimor për këtë vendim, sipas kompetencave ligjore.

KRYETAR

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.576/2 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r . 2 6

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022524, nr.3252/1 Prot., datë 29.09.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1),

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O dhe seli në Lushnjë, është rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 03/06/2022 dhe ka si objekt të aktivitetit të tij midis të tjerave si vjon : *“Import – Export. Konfeksione nen regjimin fasoneri, tregti me shumice dhe pakice te produkteve te ndryshme industrial, transport mallrave, tregti te mobiljeve, tregti te veglave te punes, makina qepse etj”*. Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 14303/1, datë 26.09.2022. Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.3252 Prot., datë 29/09/2025 me lëndë *“Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”* dhe më tej, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm nr.4198/2 prot., datë 30/10/2025, me shkresën nr.576 Prot., datë 11/02/2026 me lëndë *“Program Pune”*, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr.14303/1 datë 26.09.2022; si dhe me shkresën nr.576/1 Prot., datë 12/12/2026 me lëndë *“Informacion”*, ku midis të tjerave kanë parashtruar si vijon *“...Grupi i punës u paraqit në ambientet ku operonte subjekti. Ky ambjent ishte i hapur, por ishte në shfrytëzim nga një subjekt tjetër. Nuk kishte asnjë përfaqësues të subjektit, nuk u gjet asnjë makineri apo paisje dhe as mall lëndë e parë e importuar apo përpunuar që i takon autorizimit 14303/1 datë 29.09.2022 të subjektit SIBCO. Në QKB ky operator rezulton aktiv në këtë adresë dhe nuk kemi ndryshim adrese për ushtrimin e aktivitetit të këtij subjekti”*. Ndërsa në shkresën nr.3252 Prot., datë 29-09-2025, është përshkruar si vijon : *Sa i takon autorizimit nr.14303/1 datë 22.09.2022 situata nga sistemi Oracle është e pasqyruar sipas tabelës më poshtë :*

PROCEDURA	VLERA (EURO)	PESHA (KG)
5100 (import)	118,910	20334.45
3151 (eksport)	115,936	15,292.55
Diferenca (Importe-Eksporte-mbetje)	2,974	5,041

Nga këto të dhëna rezulton se ju keni gjendje mall lëndë të pare pa i dhënë destinacion në sasinë 5,041 kg dhe në vlerë 2,974 euro.

Të gjendur në këto kushte Dega e Doganës Fier bazuar në Ligjin 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” sipas nenit 74 “Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërbushjes”, nenit 253/b “Mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28” dhe nenit 258/1/a ka llogaritur detyrimin në shumën :

Përlllogaritja e detyrimeve :

*Detyrimi = 2,974 EUR * 20% * 97.88 Kursi = 58,219 lekë*

*Penalitet = 58,219 * 2fishi = 116,438 lekë*

Totali Detyrim + Penalitet = 174,657 lekë”

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk i është dhënë destinacion doganor mallit.

Në kuptim të legjislacionit doganor në fuqi, regjimi i përpunimit aktiv përbën një regjim ekonomik që lejon importimin e mallrave pa pagimin e detyrimeve doganore, me kusht që këto mallra të përdoren për përpunim dhe më pas të rieksporohen, ose të marrin një destinacion tjetër doganor të lejuar. Ky rregjim doganor shoqërohet me detyrime të qarta për subjektin përfitues, të cilat burojnë drejtpërdrejt nga autorizimi i dhënë dhe nga dispozitat e Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Për këtë konstatim, grupi i punës ka mbajtur Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022524, nr.3252/1 Prot., datë 29.09.2025, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes si vijon : “*Subjekti SIBCO i pajisur me autorizim të përpunimit aktiv nr.14303/1 datë 22.09.2022 ka gjendje mall lëndë të parë pa i dhënë destinacion brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit, parashikuar nga ligji 102/2014 dhe Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”. Kjo shkelje klasifikohet sipas neneve 250/1/a dhe 252/c dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i RSH”. Proces verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr.3254 Prot., datë 30/09/2025, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative, fillimin e procedurës administrative”.*

Ndërkohë, autoriteti vendimmarrës, pas njohjes me proces verbalin e lartcitur, ka proceduar me vendimin e ndërmjetëm nr.4198/2 Prot., datë 30/10/2025, me të cilin ka vendosur midis të tjerave si vijon : *1.Urdhërohet verifikimi fizik i mallrave objekt i proces-verbalit të shkeljes së lartcitur, për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale në magazinat e subjektit “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M242034020 , në prani të përfaqësuesve të Zyrës së Mbikqyrjes Doganore dhe të subjektit.*

2. Në varësi të rezultatit të verifikimit, të bëhet klasifikimi i shkeljes si më poshtë :

- Nëse mallrat ndodhen në magazinë → shkelja trajtohet si kundërvajtje administrative sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Kodit Doganor.
- Nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë → procedimi të rikualifikohet si kontrabandë, në zbatim të nenit 268 të Kodit Doganor, me pasojat penale përkatëse.

3. Derisa të përfundojë verifikimi fizik, të pezullohet përkohësisht shqyrtimi administrativ i proces-verbalit të shkeljes.

Nga analiza e fakteve të konstatuara nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier rezulton se subjekti i pajisur me autorizim për Regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) nr.14303/1 datë 26.09.2022 ka importuar mallra (lëndë të parë) nën procedurën 5100 në sasinë 20,334.45 kg dhe ka eksportuar produkt përfundimtar në sasinë 15,292.55 kg. Nga verifikimi në sistemin Oracle rezulton diferencë prej 5,041 kg lëndë e parë, për të cilën nuk i është dhënë destinacion doganor. Kontrolli fizik nuk është bërë i mundur, pasi ambienti ku operonte subjekti ushtronte aktivitetin një subjekt tjetër dhe nuk kishte asnjë makineri apo paisje dhe as mall lëndë e parë e importuar apo përpunuar që i takon autorizimit 14303/1 datë 29.09.2022 të subjektit SIBCO; pra, nuk është provuar ekzistenca fizike e mallrave dhe as vendndodhja reale e tyre. Në kuptim të nenit 74 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, borxhi doganor lind ndër të tjera kur një mall që i nënshtrohet një regjimi doganor nuk përmbush kushtet e këtij regjimi. Megjithatë, në rastin konkret, situata tejkalon kuadrin e një mosrespektimi formal të detyrimeve të autorizimit (neni 253/b), pasi a) Malli i importuar me pezullim detyrimesh doganore nuk rezulton i rieksportuar;

b) Malli nuk rezulton të jetë vendosur në një regjim tjetër doganor të lejuar;

c) Malli nuk rezulton të jetë i pranishëm fizikisht në ambientet e subjektit;

d) Subjekti ka pamundësuar kontrollin fizik të autoriteteve doganore, duke mos garantuar aksesin në ambientet ku duhej të ndodheshin mallrat nën regjimin e përpunimit aktiv. Ndërkohë, subjekti kishte detyrimin ligjor që, në rast të ndryshimit të adresës së ushtrimit të veprimtarisë apo të vendndodhjes së magazinimit të mallrave, të njoftonte paraprakisht autoritetin doganor dhe të siguronte miratimin përkatës, me qëllim garantimin e vijimësisë së mbikëqyrjes doganore.

Këta elementë përmbushin tiparet objektive të heqjes së mallrave nga mbikëqyrja doganore, çka sipas Kodit Doganor përbën kontrabandë dhe jo thjesht kundërvajtje administrative. Heqja e mallrave nga mbikëqyrja doganore konsiston në çdo veprim apo mosveprim që ka si pasojë pamundësimin e autoriteteve doganore për të ushtruar kontroll mbi mallrat që janë nën një regjim pezullues. Në rastin konkret, fakti që mallrat nuk gjenden fizikisht; nuk ekziston dokumentacion për destinacionin e tyre; subjekti nuk ka bashkëpunuar duke garantuar akses

për kontroll; tregon se mallrat janë nxjerrë jashtë kontrollit doganor dhe mund të kenë hyrë në qarkullim të lirë pa shlyer detyrimet përkatëse. Kjo sjellje përbën shmangie nga regjimi pezullues dhe heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore. Të paktën në formën e dashjes eventuale, pasi subjekti ka qenë i vetëdijshtëm për detyrimet që rridhnin nga autorizimi i RPA dhe për pasojat e mosdhënies së destinacionit doganor.

Në këto kushte, kualifikimi juridik i kryer nga ana e grupit të punës sipas neneve të cituar në process verbal (kundërvajtje administrative) rezulton i papërshtatshëm, pasi kjo dispozitë zbatohet kur kemi thjesht mosrespektim procedural të kushteve të autorizimit, ndërsa në rastin konkret kemi mungesë fizike të mallrave dhe shmangie nga kontrolli doganor.

Për rrjedhojë, veprimet e subjektit përbëjnë shkeljen doganore “kontrabandë”, në kuptim të dispozitave të Kodit Doganor që sanksionojnë heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe futjen e tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse.

Bazuar në analizën e mësipërme, rezulton se shkelja e konstatuar nuk përbën thjesht “mosrespektim të detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi – apo neglizhencë”, por përbën heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe ndoshta, futje të tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse, duke u kualifikuar si kontrabandë. Në këto kushte, Proces Verbalit nr. 0022524, nr.3252/1 Prot., datë 29.09.2025, duhet t'i bëhet rikualifikimi juridik i shkeljes nga neni 252 në dispozitat që parashikojnë kontrabandën, si dhe çështja duhet të ndiqet sipas procedurave përkatëse për këtë kategori shkeljeje. Në vijim të këtij arsyetimi, rezulton e nevojshme të analizohet edhe dispozita e posaçme që parashikon se përbën shkelje hedhja në konsum e mallrave të importuara me pezullim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet doganore, kur autoritetet doganore vërtetojnë se destinacioni përfundimtar apo përdorimi i tyre është i ndryshëm nga ai për të cilin është përfituar lehtësia doganore. Në rastin konkret, mallrat (lëndë e parë) janë importuar nën regjimin e përpunimit aktiv, i cili përbën një formë pezullimi nga detyrimet doganore, me kusht që ato të përpunohen dhe më pas të rieksporohen ose të marrin një destinacion tjetër të lejuar. Diferenca prej 5,041 kg nuk rezulton e rieksportuar, nuk rezulton e vendosur në ndonjë regjim tjetër doganor dhe nuk provohet ekzistenca fizike e saj në magazinat e subjektit.

Në këto rrethana, kur mallrat e importuara me pezullim detyrimesh nuk gjenden nën mbikëqyrje doganore dhe nuk provohet përdorimi i tyre sipas destinacionit të miratuar, krijohet prezumimi i arsyeshëm se ato janë hedhur në konsum ose përdorur për një qëllim tjetër nga ai që justifikonte përfitimin nga pezullimi i detyrimeve. Kjo situatë përputhet plotësisht me parashikimin e nenit 266/5 të Kodit Doganor, sipas së cilës humbet e drejta e përjashtimit dhe lind detyrimi i plotë doganor. Megjithatë, në ndryshim nga një rast i thjeshtë mospërmbushjeje formale të kushteve të autorizimit, këtu kemi elementë shtesë rëndues : mungesë fizike të mallrave; pamundësim të kontrollit doganor; mosdhënie të destinacionit doganor brenda afateve; mosnjohim të ndryshimit të vendndodhjes së aktivitetit.

Këta elementë tregojnë jo vetëm lindjen e borxhit doganor sipas nenit 74, por edhe realizimin e veprimeve që çojnë në heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe hedhjen e tyre të mundshme në konsum në kundërshtim me kushtet e regjimit pezullues. Pra, ndërsa dispozita mbi “hedhjen në konsum” justifikon lindjen e detyrimit doganor dhe humbjen e përfitimit, rrethanat konkrete të çështjes – në veçanti mungesa e mallrave dhe pamundësimi i kontrollit – e tejkalojnë këtë nivel dhe e çojnë sjelljen në fushën e kontrabandës, si formë e rëndë e shmangies nga regjimi doganor. Për rrjedhojë, në analizë të plotë të fakteve dhe të dispozitave ligjore të aplikueshme, rezulton se mallrat janë importuar me pezullim detyrimesh për një destinacion të caktuar; ky destinacion nuk është provuar; mallrat nuk janë nën kontroll doganor; ekziston dyshimi i arsyeshëm i hedhjes së tyre në konsum pa përmbushur detyrimet përkatëse.

Në këto kushte, kualifikimi juridik i saktë i sjelljes së subjektit nuk është ai i një kundërvajtjeje administrative sipas nenit 252, por ai i shkeljes doganore “kontrabandë”, neni 266/5, me të gjitha pasojat ligjore që rrjedhin prej saj, përfshirë rillogaritjen e detyrimeve, aplikimin e masave ndëshkimore përkatëse dhe ndjekjen e procedurave sipas natyrës së kësaj shkeljeje. Për rrjedhojë, kualifikimi i bërë fillimisht sipas nenit 252 si kundërvajtje administrative rezulton i gabuar dhe i papërshtatshëm në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **58,219** (Pesëdhjet e tetëmijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, të penalizohet në masën e trefshit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **174,657** (Njëqind e shtatëdhjet e katërmijë e gjashtëqind e pesëdhjet e shtatë) lekë, bazuar në nenin 268/2 të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Tërhiqet vëmendja e personelit doganor që, në raste të ngjashme ku konstatohet mungesë fizike e mallrave të vendosura në regjim pezullues, pamundësim i kontrollit doganor, mosdhënie e destinacionit doganor dhe elementë që tregojnë heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore, çështjet të mos trajtohen si kundërvajtje administrative formale, por të analizohen dhe kualifikohen në përputhje me dispozitat që parashikojnë shkeljen doganore “kontrabandë”, duke zbatuar me rigorozitet legjislationin doganor në fuqi.

- Në përputhje me nenin 272 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, subjekti ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen administrative të shkëljes së kualifikuar si kontrabandë, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga ky nen.
- Nëse subjekti nuk kërkon zgjidhje administrativ, kundër këtij vendimi, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
- Për vijimin e procedurave të mëtejshme, një kopje e këtij vendimi, së bashku me gjithë dokumentacionin e lartpërmendur, t’i përcillet Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë, për veprime të mëtejshme në përputhje me kompetencat ligjore. Për zbatimin e kësaj dispozite ngarkohet Zyra Juridike pranë Degës së Doganës Vlorë.
- Ngarkohet Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier që të njoftojë organin tatimor për këtë vendim, sipas kompetencave ligjore.

K R Y E T A R

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.576/3 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r. 27

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022522, nr.3252/3 Prot., datë 29.09.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1),

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O dhe seli në Lushnjë, është rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 03/06/2022 dhe ka si objekt të aktivitetit të tij midis të tjerave si vjon : *“Import – Export. Konfeksione nen regjimin fasoneri, tregti me shumice dhe pakice te produkteve te ndryshme industrial, transport mallrave, tregti te mobiljeve, tregti te veglave te punes, makina qepse etj”*. Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 14303/1, datë 26.09.2022. Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.3252 Prot., datë 29/09/2025 me lëndë *“Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” dhe më tej, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm nr.4198/2 prot., datë 30/10/2025, me shkresën nr.576 Prot., datë 11/02/2026 me lëndë “Program Pune”, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr.14303/1 datë 26.09.2022; si dhe me shkresën nr.576/1 Prot., datë 12/12/2026 me lëndë “Informacion”, ku midis të tjerave kanë parashtruar si vijon *“...Grupi i punës u paraqit në ambientet ku operonte subjekti. Ky ambjent ishte i hapur, por ishte në shfrytëzim nga një subjekt tjetër. Nuk kishte asnjë përfaqësues të subjektit, nuk u gjet asnjë makineri apo paisje dhe as mall lëndë e parë e importuar apo përpunuar që i takon autorizimit 14303/1 datë 29.09.2022 të subjektit SIBCO. Në QKB ky operator rezulton aktiv në këtë adresë dhe nuk kemi ndryshim adrese për ushtrimin e aktivitetit të këtij subjekti”*.*

Ndërsa në shkresën nr.3252 Prot., datë 29-09-2025, është përshkruar si vijon : *Ju jeni përjashtuar nga pagesa e TVSH për makineri në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e përpunimit aktiv dhe keni deklaruar se nuk janë për t'u shitur. Për këtë, ju keni marrë nga Dega e Doganës Fier Autorizim për Përjashtim nga TVSH, për makineritë dhe paisjet për aq kohë sa jeni brenda regjimit të përpunimit aktiv. Keto makineri kane ardhur perkatesisht me R12465 date 19.12.2022, R8207 date 28.07.2023, R 3119 date 27.03.2023, R 2043 date 02.03.2023, R 4224 date 21.04.2023, R 3803 date 11.04.2023, R 50 date 05.01.2023 dhe R 49 date*

05.01.2023. Kur afati i regjimit përfundon dhe nuk rinovohet sërish autorizimi, makinerive dhe pajisjeve u duhet dhënë një destinacion të cilin ju nuk e keni kryer. Si rrjedhojë, lind detyrimi doganor për mosdhënie destinacioni të pajisjeve dhe makinerive, të cilat kanë marrë përjashtim nga TVSH.

Përlllogaritja e detyrimeve :

Detyrimi 662,148 Lekë

*Penalitet = 662,148 * 2 fishi = 1,324,296 lekë*

Totali Detyrim + Penalitet = 1,986,444 Lekë.

Nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore, ka rezultuar se nga ana e subjektit nuk i është dhënë destinacion doganor mallit.

Në kuptim të legjislacionit doganor në fuqi, regjimi i përpunimit aktiv përbën një regjim ekonomik që lejon importimin e mallrave pa pagimin e detyrimeve doganore, me kusht që këto mallra të përdoren për përpunim dhe më pas të rieksporohen, ose të marrin një destinacion tjetër doganor të lejuar. Ky rregjim doganor shoqërohet me detyrime të qarta për subjektin përfitues, të cilat burojnë drejtpërdrejt nga autorizimi i dhënë dhe nga dispozitat e Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Për këtë konstatim, grupi i punës ka mbajtur Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022522, nr.3252/3 Prot., datë 30.09.2025, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes si vijon : “*Subjekti SIBCO i pajisur me autorizim të përpunimit aktiv nr.14303/1 datë 22.09.2022 ka detyrime doganore për mosdhënie destinacion të pajisjeve dhe makinerive të cilat kanë marrë Autorizim për përjashtim nga TVSH në vlerën 662,148 lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas nenit 252/c dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i RSH”.*

Proces verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr.3254 Prot., datë 30/09/2025, me lëndë “*Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative, fillimin e procedurës administrative*”.

Ndërkohë, autoriteti vendimmarrës, pas njohjes me proces verbalin e lartcitur, ka proceduar me vendimin e ndërmjetëm nr.4198/2 Prot., datë 30/10/2025, me të cilin ka vendosur midis të tjerave si vijon : *1.Urdhërohet verifikimi fizik i mallrave objekt i proces-verbalit të shkeljes së lartcitur, për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale në magazinat e subjektit “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M242034020 , në prani të përfaqësuesve të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore dhe të subjektit.*

2. Në varësi të rezultatit të verifikimit, të bëhet klasifikimi i shkeljes si më poshtë :

- *Nëse mallrat ndodhen në magazinë → shkelja trajtohet si kundërvajtje administrative sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Kodit Doganor.*

- Nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë → procedimi të rikualifikohet si kontrabandë, në zbatim të nenit 268 të Kodit Doganor, me pasojat penale përkatëse.

3. Derisa të përfundojë verifikimi fizik, të pezullohet përkohësisht shqyrtimi administrativ i proces-verbalit të shkeljes.

Në zbatim të vendimit të lartcitur, grupi i punës ka proceduar me shkresën Nr.576/1 Prot. Date 12/02/2026 me lëndë “Informacion” në të cilin kanë parashtruar si vijon : “Bazuar në vendimi e ndërmjetëm 4198/2 datë 30.10.2025 dhe Programin e Punës nr.576 Prot., date 11.02.2026 për operatorin “Sibco” mew NIPT M242034020 grupi i punës u paraqit në ambjentet ku operonte subjekti. Ky ambjent ishte i hapur, por ishte në shfrytëzim nga një subjekt tjetër. Nuk kishte asnjë përfaqësues të subjektit, nuk u gjet asnjë makineri apo pajise dhe as mall lëndë e pare e importuar apo përpunuar që i takon autorizimit 14303/1 datë 29.09.2022 të subjektit SIBCO. Në QKB ky operator rezulton aktiv në këtë adresë dhe nuk kemi ndryshim adrese për ushtrimin e aktivitetit të këtij subjekti”.

Nga analiza e fakteve të konstatuara nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier rezulton se subjekti i pajisur me autorizim për Regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) nr.14303/1, datë 26.09.2022, nuk ka përmbushur detyrimet thelbësore që burojnë nga ky regjim dhe nga autorizimi individual i dhënë nga autoriteti doganor.

Në zbatim të vendimit të ndërmjetëm nr.4198/2 Prot., datë 30.10.2025, u krye verifikimi fizik i mallrave objekt i proces-verbalit. Nga shkresa nr.576/1 Prot., datë 12.02.2026, rezulton qartë se : ambienti ku subjekti deklarohet se ushtronte aktivitetin ishte në përdorim nga një subjekt tjetër; nuk ishte i pranishëm asnjë përfaqësues i “SIBCO” sh.p.k; nuk u gjet asnjë makineri apo pajisje e importuar me përjashtim nga TVSH; nuk u gjetën mallra lëndë e parë apo produkte të përpunuara që i përkisnin autorizimit nr.14303/1; në QKB subjekti vijon të figurojë aktiv në të njëjtën adresë, pa njoftuar ndryshim adrese apo pezullim aktiviteti.

Ky konstatim ka rëndësi thelbësore, pasi përmbush kushtin e përcaktuar në pikën 2 të vendimit të ndërmjetëm, sipas të cilit, nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë, procedimi duhet të rikualifikohet si kontrabandë në kuptim të nenit 268 të Kodit Doganor.

Në rastin konkret, mungesa fizike e makinerive dhe pajisjeve të importuara me përjashtim nga TVSH, për të cilat subjekti kishte deklaruar se nuk do të shiteshin dhe do të përdoreshin vetëm në funksion të regjimit të përpunimit aktiv, përbën : shkelje të kushteve të autorizimit; mosrespektim të detyrimit për dhënie destinacioni doganor pas përfundimit të regjimit; shmangie të kontrollit doganor mbi mallrat që kanë përfituar trajtim fiskal preferencial.

Në kuptim të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, regjimi i përpunimit aktiv është një regjim ekonomik me karakter përjashtimor, i bazuar në besueshmërinë e operatorit dhe në respektimin rigoroz të

kushteve të autorizimit. Përfitimi nga përjashtimi i TVSH-së është i kushtëzuar drejtpërdrejt me përdorimin e mallrave për qëllimin e deklaruar dhe me rieksporimin apo dhënien e një destinacioni tjetër të ligjshëm.

Në kushtet kur autorizimi nuk rezulton i rinovuar; nuk është dokumentuar mbyllja e regjimit; nuk është provuar rieksporimi apo kalimi në qarkullim të lirë me pagesën e detyrimeve përkatëse; mallrat nuk gjenden fizikisht në ambientet e deklaruara; rezulton se janë përmbushur elementët objektivë të shkeljes së rëndë, duke tejkaluar kuadrin e një kundërvajtjeje administrative të thjeshtë. Për pasojë, detyrimi doganor në vlerën 662,148 lekë mbetet i ligjshëm dhe i bazuar.

Duke qenë se verifikimi fizik konfirmoi mungesën e mallrave, autoriteti vendimmarrës çmon se kushtet për trajtimin e rastit si kontrabandë, në kuptim të nenit 268 të Kodit Doganor, janë materialisht të përmbushura, pasi mallrat që kanë përfituar trajtim preferencial (lehtësi fiskale) nuk janë nën kontroll doganor dhe nuk rezulton të kenë marrë destinacion të ligjshëm. Në përfundim, në vlerësim të plotë të provave dokumentare, proces-verbalit të shkeljes, vendimit të ndërmjetëm dhe rezultatit të verifikimit fizik, rezulton se subjekti "SIBCO" sh.p.k ka vepruar në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga regjimi i përpunimit aktiv, duke krijuar jo vetëm detyrim doganor, por edhe elementë që justifikojnë rikualifikimin e procedimit sipas dispozitave përkatëse të Kodit Dogano

Këta elementë përmbushin tiparet objektive të heqjes së mallrave nga mbikëqyrja doganore, çka sipas Kodit Doganor përbën kontrabandë dhe jo thjesht kundërvajtje administrative. Heqja e mallrave nga mbikëqyrja doganore konsiston në çdo veprim apo mosveprim që ka si pasojë pamundësimin e autoriteteve doganore për të ushtruar kontroll mbi mallrat që janë nën një regjim pezullues. Në rastin konkret, fakti që mallrat nuk gjenden fizikisht; nuk ekziston dokumentacion për destinacionin e tyre; subjekti nuk ka bashkëpunuar duke garantuar akses për kontroll; tregon se mallrat janë nxjerrë jashtë kontrollit doganor dhe mund të kenë hyrë në qarkullim të lirë pa shlyer detyrimet përkatëse. Kjo sjellje përbën shmangie nga regjimi pezullues dhe heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore. Të paktën në formën e dashjes eventuale, pasi subjekti ka qenë i vetëdijshëm për detyrimet që rridhnin nga autorizimi i RPA dhe për pasojat e mosdhënies së destinacionit doganor.

Në këto kushte, kualifikimi juridik i kryer nga ana e grupit të punës sipas neneve të cituar në proces verbal (kundërvajtje administrative) rezulton i papërshtatshëm, pasi kjo dispozitë zbatohet kur kemi thjesht mosrespektim procedural të kushteve të autorizimit, ndërsa në rastin konkret kemi mungesë fizike të mallrave dhe shmangie nga kontrolli doganor.

Për rrjedhojë, veprimet e subjektit përbëjnë shkeljen doganore "kontrabandë", në kuptim të dispozitave të Kodit Doganor që sanksionojnë heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe futjen e tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse.

Në këto rrethana, kur mallrat e importuara me përjashtim TVSH nuk gjenden nën mbikëqyrje doganore dhe nuk provohet përdorimi i tyre sipas destinacionit të miratuar, krijohet prezumimi i arsyeshëm se ato janë hedhur në konsum ose përdorur për një qëllim tjetër nga ai që justifikonte përfitimin nga pezullimi i detyrimeve. Kjo situatë përputhet plotësisht me parashikimin e nenit 266/5 të Kodit Doganor, sipas së cilës humbet e drejta e përjashtimit dhe lind detyrimi i plotë doganor. Megjithatë, në ndryshim nga një rast i thjeshtë mospërmbushjeje formale të kushteve të autorizimit, këtu kemi elementë shtesë rëndues : mungesë fizike të mallrave; pamundësim të kontrollit doganor; mosdhënie të destinacionit doganor brenda afateve; mosnjohim të ndryshimit të vendndodhjes së aktivitetit etj, etj.

Këta elementë tregojnë jo vetëm lindjen e borxhit doganor sipas nenit 74, por edhe realizimin e veprimeve që çojnë në heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe hedhjen e tyre të mundshme në konsum në kundërshtim me kushtet e regjimit pezullues. Pra, ndërsa dispozita mbi “hedhjen në konsum” justifikon lindjen e detyrimit doganor dhe humbjen e përfitimit, rrethanat konkrete të çështjes – në veçanti mungesa e mallrave dhe pamundësimi i kontrollit – e tejkalojnë këtë nivel dhe e çojnë sjelljen në fushën e kontrabandës, si formë e rëndë e shmangies nga regjimi doganor. Për rrjedhojë, në analizë të plotë të fakteve dhe të dispozitave ligjore të aplikueshme, rezulton se mallrat janë importuar me pezullim detyrimesh për një destinacion të caktuar; ky destinacion nuk është provuar; mallrat nuk janë nën kontroll doganor; ekziston dyshimi i arsyeshëm i hedhjes së tyre në konsum pa përmbushur detyrimet përkatëse.

Në këto kushte, kualifikimi juridik i saktë i sjelljes së subjektit nuk është ai i një kundërvajtjeje administrative sipas nenit 252, por ai i shkeljes doganore “kontrabandë”, neni 266/5, me të gjitha pasojat ligjore që rrjedhin prej saj, përfshirë rilogaritjen e detyrimeve, aplikimin e masave ndëshkimore përkatëse dhe ndjekjen e procedurave sipas natyrës së kësaj shkeljeje.

Për rrjedhojë, kualifikimi i bërë fillimisht sipas nenit 252 si kundërvajtje administrative rezulton i gabuar dhe i papërshtatshëm në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **662,148** (Gjashtëqind e gjashtëdhjet e dymijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.

- Subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, të penalizohet në masën e trefishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 1,986,444 (Njëmilion e nëntëqind e tetëdhjet e gjashtëmijë e katërqind e dyzet e katër) lekë, bazuar në nenin 268/2 të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Tërhiqet vëmendja e personelit doganor që, në raste të ngjashme ku konstatohet mungesë fizike e mallrave të vendosura në regjim pezullues, pamundësim i kontrollit doganor, mosdhënie e destinacionit doganor dhe elementë që tregojnë heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore, çështjet të mos trajtohen si kundërvajtje administrative formale, por të analizohen dhe kualifikohen në përputhje me dispozitat që parashikojnë shkeljen doganorë “kontrabandë”, duke zbatuar me rigorozitet legjislacionin doganor në fuqi.
- Në përputhje me nenin 272 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, subjekti ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen administrative të shkeljes së kualifikuar si kontrabandë, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga ky nen.
- Nëse subjekti nuk kërkon zgjidhje administrativ, kundër këtij vendimi, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
- Për vijimin e procedurave të mëtejshme, një kopje e këtij vendimi, së bashku me gjithë dokumentacionin e lartpërmendur, t’i përcillet Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë, për veprime të mëtejshme në përputhje me kompetencat ligjore. Për zbatimin e kësaj dispozite ngarkohet Zyra Juridike pranë Degës së Doganës Vlorë.
- Ngarkohet Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier që të njoftojë organin tatimor për këtë vendim, sipas kompetencave ligjore.

K R Y E T A R

Kosta Vjero






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.577/2 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r . 2 8

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022522, nr.3246 Prot., datë 29.09.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjja "Kryengritja e Fierit", (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531),

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P dhe seli në Fier, është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 24/03/2022 dhe ka si objekt të aktivitetit të tij si vjon : *"Prodhim i limave profesionale për thonjtë. Konsulenca tregetare, mediator. Eksport-Import të të gjitha mallrave të lejuara me ligj. Kërkim të tregjeve"*.

Subjekti "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 9446/1, datë 30.03.2022.

Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.2500 Prot., datë 22/07/2025 me lëndë *"Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 "Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv"*, në të cilën grupi i punës ka parashtruar si vijon :

Në vijim të attributeve të autoritetit doganor, bazuar në ligjin nr. 104/2012 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" dhe zbatueshmërisë së Udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019, "Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv", kreu XIV, pika 1, "Detyrimet e operatorit ekonomik ndaj Degës Doganore Mbikëqyrëse", Sektori i Mbikëqyrjes Doganore i Degës së Doganës Fier ka shqyrtuar dosjen tuaj dhe ka kryer verifikimet përkatëse në sistemin Oracle.

Sa i takon autorizimit nr. 9446/1, datë 30.03.2022, situata nga sistemi Oracle është e pasqyruar sipas tabelës më poshtë :

PROCEDURA VLERA (EURO) PESHA (KG) TAKSA (ALL)
5100 (import) 31,466 4,993.5 351,728
3151 (eksport) 10,673 999.5 -
Diferenca (importe – eksporte) 20,793 3,994 351,728

Nga këto të dhëna rezulton se ju keni ende gjendje malli, lëndë të parë, pa i dhënë destinacion, në sasinë 3,994 kg dhe me vlerë 20,793 euro.

Të gjendur në këto kushte, Dega e Doganës Fier, bazuar në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014, "Kodi Doganor i RSH-së", sipas nenit 74 "Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërmbyshjes", nenit 252/b "Mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1 të nenit 28" dhe nenit 257/1/a, ka llogaritur detyrimin në shumën:

Përlllogaritja e detyrimeve:

Detyrimi: 20,793 EUR × 20% × 98.08 (kursi) = 407,875 lekë

Gjithashtu, bazuar në Udhëzimin nr. 4, datë 28.03.2019, "Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv", kapitulli IX, pika 4, "Mbyllja e regjimit të përpunimit aktiv", ju nuk keni dorëzuar Aneksin 8 "Dokument i mbylljes së Regjimit", çka sjell mosrespektimin e kushteve të autorizimit.

Këto shkelje klasifikohen sipas neneve 250/1/a dhe 252/c "Mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim" dhe sanksionohen sipas nenit 257/1/b të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

Për sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i RSH-së", neni 23 "Dhënia e informacionit autoriteteve doganore", brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit, ju duhet të paraqisni të gjitha informacionet e nevojshme, të shoqëruara me material dhe dokumentacion përkatës.

Në vijim, nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore ndaj subjektit është evidentuar një shkelje doganore, e cila është pasqyruar në proces-verbalin e shkeljes, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon: "Subjekti 'SILVER BLU Production' i pajisur me autorizim të Regjimit të Përpunimit Aktiv nr.9446/1 datë 30.03.2022, ka gjendje mall lëndë të parë pa i dhënë destinacion brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit, të parashikuar nga Ligji nr.102/2014 dhe Udhëzimi nr.04 'Mbi zbatimin praktik të RPA'. Kjo shkelje klasifikohet sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të Ligjit nr.102/2014 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë'."

Nga ana e grupit të kontrollit, subjekti është shpallur përgjegjës për detyrimin e shmangur në shumën 407,875 (katërqind e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, si dhe është penalizuar në masën e dyfishit të detyrimit doganor të shmangur, në shumën 815,750 (tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.

Proces-verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 3246/2 prot., datë 29.09.2025, si dhe me lajmërim publik. Nga përmbajtja e proces-verbalit rezulton se shkelja është klasifikuar nga grupi i kontrollit si kundërvajtje administrative, në kuptim të neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", dhe sanksionohet sipas nenit 257/1/a të po këtij ligji.

Ndërkohë, autoriteti vendimmarrës, pas njohjes me proces verbalin e lartcituar, ka proceduar me vendimin e ndërmjetëm nr.3246/6 Prot., datë 30/10/2025, me të cilin ka vendosur midis të tjerave si vijon :

1. Urdhërohet verifikimi fizik i mallrave objekt i proces-verbalit të shkeljes së lartcituar, për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale në magazinat e subjektit "SILVER BLU Production" sh.p.k, në prani të përfaqësuesve të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore dhe të subjektit.

2. Në varësi të rezultatit të verifikimit, të bëhet klasifikimi i shkeljes si më poshtë :

- Nëse mallrat ndodhen në magazinë → shkelja trajtohet si kundërvajtje administrative sipas neneve 250/1/a dhe 252/2/c të Kodit Doganor.
- Nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë → procedimi të rikualifikohet si kontrabandë, në zbatim të nenit 268 të Kodit Doganor, me pasojat penale përkatëse.

3. Derisa të përfundojë verifikimi fizik, të pezullohet përkohësisht shqyrtimi administrativ i proces-verbalit të shkeljes.

4. Ky vendim i ndërmjetëm t'i njoftohet subjektit "SILVER BLU Production" sh.p.k me NUIS M22724402P dhe Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për zbatim të menjëhershëm.

Ky vendim i është njoftuar subjektit me anë të shërbimit postar, lajmërimit public, si dhe me anë të njoftimit elektronik. Në zbatim të vendimit të lartcituar, grupi i punës ka proceduar me shkresën Nr.577/1 Prot. Datë 12/02/2026 me lëndë "Informacion" në të cilin kanë parashtruar si vijon : "Bazuar në vendimin e ndërmjetëm 3246/6 datë 30.10.2025 dhe Programin e Punës nr.577 Prot., datë 11.02.2026 për operatorin ekonomik "Silver Blue" me NIPT M22724402P grupi i punës u paraqit në ambientet ku operonte subjekti. Kjo magazinë ishte e mbyllur dhe për pasojë nuk u bë i mundur kontrolli i këtyre ambienteve. Në QKB ky operator rezulton aktiv në këtë adresë dhe nuk kemi ndryshim adrese për ushtrimin e aktivitetit të këtij subjekti".

Nga analiza e fakteve të konstatuara nga Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier rezulton se subjekti i pajisur me autorizim për Regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) nr. AL 9446/1, datë 30.03.2022, nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky autorizim, si në drejtim të mbylljes së regjimit brenda afateve të përcaktuara, ashtu edhe në drejtim të garantimit të gjurmueshmërisë dhe kontrollueshmërisë së mallrave të futura në regjimin e përpunimit aktiv. Fakti që, në momentin e ushtrimit të kontrollit fizik, ambientet e deklaruara si vend ushtrimi aktiviteti kanë rezultuar të mbyllura, duke e bërë të pamundur verifikimin e pranisë ose jo të mallrave objekt i proces-verbalit të shkeljes, përbën rrethanë të rëndësishme për vlerësimin juridik të çështjes. Subjekti, në cilësinë e përfituesit të autorizimit për RPA, ka detyrimin ligjor të sigurojë në çdo kohë akses të plotë për autoritetet doganore, si dhe të mbajë mallrat dhe dokumentacionin përkatës në mënyrë të tillë që të mundësojë kontrollin efektiv nga ana e administratës doganore.

Mosgjethja e subjektit në adresën e regjistruar dhe pamundësia objektive për të ushtruar kontrollin fizik, në kushtet kur nuk rezulton asnjë njoftim për ndryshim adrese apo pezullim aktiviteti pranë organeve përkatëse, krijon prezumimin e arsyeshëm se mallrat objekt i regjimit doganor nuk ndodhen në magazinën e deklaruar dhe, për rrjedhojë, nuk janë nën mbikëqyrje doganore, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Në këto kushte, duke qenë se subjekti nuk ka dorëzuar dokumentin e mbylljes së regjimit (Aneksi 8); rezulton diferencë e pajustificuar midis importeve dhe eksporteve në sasinë 3,994 kg; nuk është bërë i mundur verifikimi fizik i mallrave për shkak të mungesës së aksesit në ambientet e subjektit; autoriteti vendimmarrës çmon se ekzistojnë elementë të mjaftueshëm faktikë dhe juridikë për të vlerësuar se mallrat nuk ndodhen nën kontroll doganor dhe se kemi të bëjmë me shmangie nga mbikëqyrja doganore.

Për pasojë, në zbatim të nenit 268 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, veprimet/mosveprimet e subjektit paraqesin elementë të veprës së shkeljes doganore “kontrabandë”, duke tejkaluar kuadrin e një kundërvajtjeje administrative. Në përfundim, mbi bazën e fakteve të administruara, dokumentacionit të shqyrtuar dhe rezultateve të kontrollit, autoriteti vendimmarrës arrin në përfundimin se procedimi administrativ i nisur fillimisht si kundërvajtje duhet të rikualifikohet, duke vijuar me ndjekjen e procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë referimin e çështjes pranë organeve kompetente për vlerësimin e përgjegjësive penale. Ky vlerësim bëhet në respektim të parimit të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes së interesave financiare të shtetit, si dhe në funksion të garantimit të zbatimit korrekt të regjimeve doganore dhe integritetit të sistemit të mbikëqyrjes doganore. Në këto kushte, kualifikimi juridik i kryer nga ana e grupit të punës sipas neneve të cituar në proces verbal (kundërvajtje administrative) rezulton i papërshtatshëm, pasi kjo dispozitë zbatohet kur kemi thjesht mosrespektim procedural të kushteve të autorizimit, ndërsa në rastin konkret kemi mungesë fizike të mallrave dhe shmangie nga kontrolli doganor.

Për rrjedhojë, veprimet e subjektit përbëjnë shkeljen doganore “kontrabandë”, në kuptim të dispozitave të Kodit Doganor që sanksionojnë heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe futjen e tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse. Në këto kushte, kualifikimi juridik i saktë i sjelljes së subjektit nuk është ai i një kundërvajtjeje administrative sipas nenit 252, por ai i shkeljes doganore “kontrabandë”, neni 266/5, me të gjitha pasojat ligjore që rrjedhin prej saj, përfshirë rillogaritjen e detyrimeve, aplikimin e masave ndëshkimore përkatëse dhe ndjekjen e procedurave sipas natyrës së kësaj shkeljeje. Kualifikimi i bërë fillimisht sipas nenit 252 si kundërvajtje administrative rezulton i gabuar dhe i papërshtatshëm në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 407,875 (Katërqind e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjet e pesë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, të penalizohet në masën e trefshit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 1,223,625 (Një milion e dyqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë, bazuar në nenin 268/2 të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Tërhiqet vëmendja e personelit doganor që, në raste të ngjashme ku konstatohet mungesë fizike e mallrave të vendosura në regjim pezullues, pamundësim i kontrollit doganor, mosdhënie e destinacionit doganor dhe elementë që tregojnë heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore, çështjet të mos trajtohen si kundërvajtje administrative formale, por të analizohen dhe kualifikohen në përputhje me dispozitat që parashikojnë shkeljen doganore “kontrabandë”, duke zbatuar me rigorozitet legjislacionin doganor në fuqi.
- Në përputhje me nenin 272 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, subjekti ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen administrative të shkeljes së kualifikuar si kontrabandë, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga ky nen.
- Nëse subjekti nuk kërkon zgjidhje administrativ, kundër këtij vendimi, i lejohe të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
- Për vijimin e procedurave të mëtejshme, një kopje e këtij vendimi, së bashku me gjithë dokumentacionin e lartpërmendur, t’i përcillet Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë, për veprime të mëtejshme në përputhje me kompetencat ligjore. Për zbatimin e kësaj dispozite ngarkohet Zyra Juridike pranë Degës së Doganës Vlorë.
- Ngarkohet Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier që të njoftojë organin tatimor për këtë vendim, sipas kompetencave ligjore.

K R Y E T A R

Kosta Vjero



